

Specifikacion për konceptin, incizimin dhe produksionin e filmit dokumentar me rastin e 10 vjetorit të Universitetit të Evropës Juglindore

Emri i projektit: FILM DOKUMENTAR kushtuar 10 vjetorit të Universitetit të Evropës Juglindore.

Shërbime konsultuese: Konceptioni, incizimi dhe produksioni i filmit dokumentar me rastin e 10 vjetorit të Universitetit të Evropës Juglindore

Universiteti i Evropës Juglindore fton të gjithakompanitë e kualifikuara të shprehin interesin e tyre për kryerjen e këtyre shërbimeve:

1. Konceptioni i skenarit, incizimi dhe montimi i filmit dokumentar në kohëzgjatje prej 10 minutave, me transmetim në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze dhe me përkthim (titrim) adekuat në gjuhën angleze, përkatësisht në gjuhën shqipe. Detyra do të përfshijë (por edhe nuk do të jetë e kufizuar), përgatitjen e skenarit, sigurimin e kameramanëve dhe të pajisjes shoqëruese, montuesit dhe studios për montim, si dhe sigurimin e transmetuesit për sinkronizim. Filmi dokumentar do ta paraqesë momente dhe objekte të zgjedhura (në suaza të Universitetit nga themelimi e deri më tani). Filmi dokumentar, gjithashtu do ta prezantojë historikun dhe imazhin e universitetit përmes video paraqitjes, narracionit dhe tekstit, i cili do të paraqesë krijimin, rezultatet e arritura dhe të ardhmen e universitetit përmes një gërshetimi të strukturuar tematik.

Filmi dokumentar do të përfshijë edhe materialet e arkivuara nga Universiteti dhe mediumet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Kompania duhet ta dorëzojë prodhimin final (filmin dokumentar), në versionet e kërkuara gjuhësore. Njësia për zbatimin e projektit në Universitet do ta koordinojë punën e kompanisë realizuese.

Kompanitë e interesuara duhet t'i dorëzojnë informatat e nevojshme: broshurën, përshkrimin e detyrave të ngjashme, përvojën në kushte të njëjta, posedimin e njohurive përkatëse nga personeli etj., të cilët do ta dëshmojnë përvojën dhe aftësinë e tyre për zbatimin e suksesshëm të konceptionit të skenarit, të incizimit dhe montimit të filmit dokumentar (fjala është për posedimin e personelit dhe pajisjeve adekuate dhe aftësive për të montuar filmin dokumentar në gjuhën angleze, shqipe dhe maqedonase).